

02. nga Adami tek Abrahami

«Madje as nuk dyshoi nga mosbesimi ne lidhje me premtimin e Perendise, por u perforcua ne besim, duke i dhene lavdi Perendise, plotesisht i bindur se ate qe Ai kishte premtuar, ishte edhe i fuqishem ta bente» ROMAKET 4 :21-22

QELLIMI

Te mesohet nga shembuj biblike, rendesia e bindjes ne jeten e krishtere.

HYRJA

Renia e Adami nuk ndikoi vetem ne mardhenien miqesore ndermjet njeriut dhe Zotit, por shkaktoi gjithashtu nje thyerje ne mardheniet ndernjerezore. Renia e njeriut u theksua me teper me vrasjen e Abelit nga vellai i tij Kain.

Ndersa njerezimi filloi te shijoje nje civilizim pa Zotin, dhuna dhe vdekja u bene realitet i perditshem ne te perditshtmen njerezore.

Duke gjetur vetem Noen dhe familjen e tij te denje per te shpetuar, Zoti vendosi te shkaterroje njerezimin me permbytje. Megjithate edhe pas permbytjes natyra mekatore e njeriut nuk ndryshoi edhe aq, duke e detyruar Perendine, te mernte edhe nje mase tjeter te dhimbshme. Kesaj here nepermjet ndryshimit te gjuheve dhe shperndarjes se njerezimit neper te gjitha siperfaqen e tokes.

Megjithetketo ne shikojme deshiren e Perendise per te krijuar nje lidhje me njerezit, nepermjet historise se Abrahamit, Isaakut, Jakobit dhe Jozefit. Linja e zgjedhur prej Abrahamit nepermjet Isaakut solli ardhjen e Mesias se shumepritur, Jezus Krishtit si plotesues i premtimeve te dhena kohe me pare nga Perendia.

STUDIMI

Kaini dhe Abeli

1. Perse njera sakrifice i pelqeu Zotit, ndersa tjetra jo (Zan 4)
2. Cfare mendoni ju se vargu 7 nenkupton (Zan 4 :7)
3. Lexo Hebrejete 11 :4. Cfare roli luajti besimi ne sakrificen e Kainit dhe Abelit (Heb 11 :4)
4. Jep te pakten nje shembull aktual te dy llojeve te sakrificave.

Noeu

1. Perse i erdhi Zotit keq qe krijoi njerezimin (Zan 6 :5-7)
2. Perse u zgjodh Noeu te ndertonte arken, dhe jo dikush tjeter (Zan 6 :8-9)
3. Cfare ju mendoni se Zoti permbushi me ane te Noeut (Zan 6 :17-22 ; Heb 11 :7)

Abrahami

1. Abrahami mban nje vend te vecante ne historine e botes. Te pakten tre religjione pretendojne se Abrahami ishte ati i besimit te tyre; Krishterizmi, Islamizmi dhe Judaizmi. Si e mbeshtet secili religjion kete argument (Zan 12:2-3; 16:4; dhe 17:19)
2. Perse ju mendoni, Perendia i beri nje kerkese te tille Abrahamit (Zan 22:1-2)
3. Studioni Zanafillen 22:8 dhe shpjegoje
4. Si shprehet dashuria e Perendise, nepermjet bindjes se Abrahamit

APLIKIMI

A – Cfare mesimi te rendesishem praktik mesuat prej histories se Kainit

B – A mendoni se do te kishit qene anetar i arkës se Noeut? Pse po dhe pse jo!

C – A ke qene ti apo familja jote te bekuar nga bekimi qe Zoti i dha Abrahamit ne Zan 12 :3

D – Si historia e Abrahamit duke ofruar birin e tij Isaakun, ndikon ne rritjen e besimit tuaj